



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË  
FAKULTETI I MJEKËSISË DENTARE

Nr. 30 Prot

Tiranë, më 19/01/2022

**LËNDA:** Publikim i vendeve për personel akademik me kohë të pjesshme në Departamentin e Terapisë.

Mbështetur në Urdhërin e Rektorit Nr. 94, datë 15.09.2021 “Për punësimin e personelit akademik me kohë të pjesshme, për vitin akademik 2021-2022 , në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë”, Fakulteti i Mjekësisë Dentare, bazuar në kërkesën e Shefit të Departamentit të Terapisë me Nr. Prot. 27, date 19.01.2022, shpall kriteret e përgjithshme, preferenciale dhe vendet vakant për programin “Master i Shkencave në Stomatologji”, në Departamentin e Terapisë Stomatologjike si më poshtë:

**KRITERET QË DUHET TË PLOTËSOJË PERSONELI AKADEMIK ME KOHË TË PJESSHME**

- Të jetë diplomuar në programe të integruara ose Master Shkencor në degën përkatëse,
- Të ketë gradën Doktoraturë/Titull Shkencor;
- Të ketë specializim në degën përkatëse
- Të ketë përfunduar me notë mesatare mbi 8,
- Të ketë eksperiencë pune mbi 5 vjet,
- Të zotërojë me dëshmi një gjuhë të huaj perëndimore, preferohet gjuha angleze,
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë nga Gjykata,
- Të ketë eksperiencë mësimdhënie në programet mësimore në fushën përkatëse,
- Të ketë publikime në revista shkencore/referime në aktivitete shkencore brenda dhe jashtë vendit.

*Aplikimet pranë zyrës së Protokollit të Fakultetit të Mjekësisë Dentare fillojnë në datën 19.01.2022 deri në datën 26.01.2022*

Dosja e aplikantit duhet të përmbajë këto dokumente :

1. Kërkesë me shkrim
2. Curriculum Vitae në formatin Europas
3. *Leje nga punëdhënsi*
4. Dokument identifikimi



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË  
FAKULTETI I MJEKËSISË DENTARE

5. Kopje të noterizuar të diplomave universitare (Bachelor, Master, Doktoraturë, Tituj Shkencor)
6. Kopje të noterizuar të diplomës dhe listëts së notave të të gjitha programeve të studimit
7. Kopje e noterizuar të gjuhës së huaj
8. Kopje e noterizuar të Librezës së Punës
9. Vërtetim page, shoqëruar me derdhjen e Sig.Shoqërore nga qendra e punës
10. Dëshmi Penaliteti
11. Dy referenca nga të cilat të paktën njëra të jetë nga një Profesor i Fakultetit ku është diplomuar

Vendet vakante janë sa më poshtë :

1. Departamenti i Terapisë Stomatologjike 2

DEKAN

Prof. Asc. Edit XHAJANKA

